



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**AC-I-22-0583-A0001**

**Në çështjen juridike të:**

L M, fshati X- Gjakovë.

**Paditësi**

**Kundër:**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.**

**E paditura/ankuesja**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-0826, të datës 14 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. **Ankesa e të paditurës refuzohet si pa bazuar.**
2. **Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-0826, të datës 14 shtator 2022.**
3. **Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedure ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 13 shkurt 2014, paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJSK kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të NSH "Modeli", e administruar nga AKP (AL i AKP-së) PEJ150-0040, të datës 21 janar 2014. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 522.36 euro, për periudhën mars – maj 2006, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së

Bashkuar (LPB). Paditësi kishte pohuar se AKP-ja ka bërë shkelje të nenit 361.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore nr.04/L-077, shkelje të nenit 368 të LMD, shkelje të nenit 99 par 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, aplikim të gabuar dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj ka propozuar që të aprovet ankesa e tij si e bazuar dhe t'i njihet e drejta në kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 522.36 euro.

Më 10 mars 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura pohoi se kërkesa e paditësit është parshkruar në pajtim me nenin 608 të LPB-së. E paditura propozon që ankesa e parashtruesit të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së.

Më 14 shtator 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-14-0826, me të cilin ishte aprovuar si e bazuar ankesa e paditësit, ishte ndryshuar Vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së dhe ishte obliguar e paditura që paditësit, në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhën 01 mars-31 maj 2006, t'i paguajë shumën prej 522.36 euro, në procedurë të likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj. Në arsyetim të vendimit thuhet se me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 522.36 euro, gjykata është bazuar në listën për pagat e pa paguara, ashtu që për muajin mars 2006 i është njohur shuma prej 174.12 euro, për muajin prill i është njohur paga në shumë prej 174.12 euro dhe për muajin maj në shumë prej 174.12 euro.

Shkalla e parë kishte konstatuar se pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar, nuk është i saktë, ngase ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë Autoritetit të Likuidimit më 11 nëntor 2013, dhe parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 16 prill 2007. Sipas Shkallës së parë vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartëcekur është njoftuar se kërkuesat kreditore mund t'i parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit. Andaj duke u nisur nga kjo gjendje Së shtë e qartë se paditësi kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh për pagat për periudhën e lartëcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e pa paguara.

Më 19 tetor 2022, e paditura/ankuesja kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në pajtim me nenin 9.10 të Ligjit 06/L-086,

duke e refuzuar ankesën ndaj vendimit të kundërshtuar të AL të AKP-së, si dhe duke e vërtetuar këtë vendim. Sipasa ankueses, Shkalla e parë ka ngatërruar dy afate krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Afati i parë është afati për parashtrim të Kërkesave, që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedure të likudimit. Ky afat kërkesën e parashtruesit e bënë të pranueshme dhe nuk ka të bëjë me meritat e kërkesës. Afati i dytë ka të bëjë me meritat e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatojë në kërkesë, andaj një kreditor i NSH-së duhet t'i përmbushë të dy afatet, në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet. Nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër.

Ankuesja e kundërshton konstatimin e Shkallës së parë se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpreu parashkrimin. Ankuesja sqaron se njoftimi të cilit i referohet parashtruesi, e informon atë se ai ka të drejtë të parashtrorj kërkesë pranë AKP-së, e jo që ai nuk ka më nevojë t'i mbrojë të drejtat e tij me mjete të tjera ligjore të cilat janë në dispozicion, dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen në process të likudimit. Në fakt, kërkesa e parashtruesit është shqyrtuar nga AL i AKP-së dhe në fund të procesit të shqyrtimit është konstatuar se ajo është e parashkruar .E paditura konisderon se paditësit i ka takuar që të dorëzoj dëshmi në gjykatë, apo në ndonjë organ tjetër kompetent.

Më 19 tetor 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së e ka dërguar tek paditësi këtë ankesë për përgjigje. Paditësi e kishte pranuar urdhrin gjyqësor më 23 tetor 2023, por nuk ka dreguar asnjë përgjigje ndaj ankesës së të paditurës

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të ligjit nr.06/L086 mbi Dhomën e Posqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për qështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

AL i AKP-së kishte refuzuar kërkesën e paditësit për shkak se kërkesa ishte parashkruar konform nenit 608 të LPB-së, ndërsa me aktgjykimin e ankimuar Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, kishte ndryshuar vendimin e kundërshtua të AL të AKP-së, duke e obliguar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhën 01 mars-31 maj 2006, t'i paguaj shumën prej 522.36 euroNë

arsyetim të vendimit thuhet se me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 522.36 euro, gjykata është bazuar në listen për pagat e pa paguara, ashtu që për vitin 2006, përkatësisht për muajin mars i është njohur në shumë prej 174.12 euro, për muajin prill i është njohur paga në shumë prej 174.12 euro, për muajin maj në shumë prej 174.12 euro.

E paditura nuk pajtohet me gjetjet dhe konstatimet e Shkallës së parë, as sa l përket parashkrimit dhe sa l përket njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Kolegji i Apelit pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të të paditurës, aktgjykimin e ankimuar dhe shkresat e landës ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor.

Kolegji i Apelit pajtohet me gjetjet dhe konstatimet e Shkallës së parë lidhur me vendimin për njohje të së drejtës së paditësit, për paga të pa paguara në shumën e aprovuar, pasi që i vetmi argument kundërshtues i AKP-së ishte se kërkesa është parashkruar. Ky pretendim i AKP-së nuk është i mbështetur në asnjë argument e as bazë ligjore.

Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me vlerësimin e Shkallës së parë se kërkesa nuk është parashkruar, pasi që me njoftimin për ndërpreje të marrëdhënies së punës që AKM i kishte dërguar paditëses më 16 prill 2007, siç ka konstatuar edhe Shkalla e parë, ishte ndërprerë parashkrimi.

AKP ka pretenduar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk është proveë relevante pasi që ky është vetëm një njoftim shabllon që u dërgohet të gjithë kreditorëve të mundshëm, për t'i lajmëruar rreth faktit se NSH-ja ka filluar procedurat e likudimit dhe se mund të dorëzojnë ndonjë kërkesë, nëse pretendojnë se e kanë një të tillë.

Kolegji i Apelit nuk e pranon këtë argument të AKP-së, pasi që ky njoftim i adresohet paditësit personalisht dhe me të dëshmohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si pasojë e veprimit, gjegjësisht vendimit të Agjencisë. Me këtë njoftim gjithashtu dëshmohet se punëdhënësi e kishte pranuar borxhin dhe e kishte udhëzuar paditësen që këtë kërkesë mund ta dorëzojë në procedurë të likudimit, kur të fillojnë këto procedura.

Mëqenëse aspkete të tjera të kësaj kërkesë nuk janë kundërshtuar nga AKP, pos aspektit të paarshkrimit, atëherë ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, për arsye që u dhanë më lartë dhe rrjedhmisht vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

AKP për ankesën e saj tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së më 14 dhjetor 2023.

**Mr.Sc Sahit Sylejamni gjyqtar kryesues** \_\_\_\_\_